



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 722 Akti

Nr. 719 Vendimi

Tiranë, më 24.11.2023

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Etleda Çiftja</b>	Kryesuese
<b>Lulzim Hamitaj</b>	Relator
<b>Brunilda Bektoshi</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 21.11.2023, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

#### **SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:**

**Znj. Pranvera Gruda**, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Prokurorisë së Përgjithshme (aktualisht prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë).

#### **OBJEKTI:**

**Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

#### **BAZA LIGJORE:**

**Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Pranvera Gruda, e cila në seancën dëgjimore publike të datës 21.11.2023 kërkoi konfirmimin në detyrë,

### V Ë R E N:

#### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Pranvera Gruda në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, ka mbajtur funksionin e ndihmësit ligjor, për rrjedhojë, në zbatim të pikës 3 të kësaj dispozite dhe parashikimit të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, gëzon statusin e subjektit të rivlerësimit e, kësaj, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*<sup>1</sup>.
2. Subjekti i rivlerësimit Pranvera Gruda i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur në datën 15.12.2020 nga Komisioni, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
3. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 21.12.2020, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Etleda Çiftja, pasi të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit. Relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
4. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga subjekti i rivlerësimit janë nisur procedurat e rivlerësimit, si vijojnë:
  - a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016 pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
  - b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-DSIK, në vijim AKSIK), brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
  - c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>1</sup> Gjithashtu, ka rezultuar se znj. Gruda, në datën 8.9.2017, kishte paraqitur një kërkesë drejtuar Komisionit, me të cilën ajo kërkonte kryerjen e procesit të rivlerësimit ndaj saj, në cilësinë e ish-prokurores, nëse ishte rastë. Lidhur me këtë fakt Komisioni – për sa kohë ka verifikuar, vlerësuar dhe konstatuar ekzistencën dhe plotësimin e kriterëve ligjore, për cilësimin e znj. Gruda, si një prej subjekteve të rivlerësimit *ex officio* (në momentin e hyrjes në fuqi të dispozitave kushtetuese e ligjore përkatëse) – nuk e ka parë të nevojshëm shqyrtimin e kësaj kërkesë.

5. Gjatë hetimit administrativ, konkretisht, në datën 18.1.2021 subjekti i rivlerësimit është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues, duke i kërkuar gjithashtu të shprehej lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit me anëtarët e tij. Subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike, po të datës 18.1.2021, konfirmoi mospasjen e ndonjë konflikti interesi me të tre anëtarët e trupit gjykues.
6. Pas përfundimit të fazës hetimore mbi rivlerësimin e subjektit Pranvera Gruda, me vendimin nr. 2, datë 16.11.2023, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.
7. Gjithashtu, në datën 16.11.2023, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe e ftoi atë për t'u njohur me dosjen dhe provat e administruara, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 e 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, për të paraqitur shpjegimet dhe për të provuar të kundërtën e rezultateve të kristalizuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë për përgatitjen e mbrojtjes së saj.
8. Subjekti i rivlerësimit u paraqit në datën 17.11.2023 pranë Komisionit, ku njoh me dokumentacionin e dosjes së hetimit administrativ dhe tërhoqi kopje të dokumentacionit. Më tej, subjekti paraqiti prapësimet dhe shpjegimet e saj, brenda afatit të caktuar nga Komisioni.
9. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet dhe dokumentet mbështetëse, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet vendimit nr. 3, datë 20.11.2023, vendosi caktimin e seancës dëgjimore në datën 21.11.2023, duke e njoftuar subjektin përmes postës elektronike, për këtë vendimmarrje.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

10. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 21.11.2023, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.
11. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, znj. Pranvera Gruda parashitri shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 21.11.2023 u mbyll për të rifilluar më 24.11.2023 për shpalljen e vendimit.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

12. Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

## **IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI**

13. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës së dorëzuar në

Komision nga AKSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLP-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimit administrativ; (viii) argumentimet e paraqitura në seancën dëgjimore; (ix) faktet e njohura botërisht.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

14. Bazuar në nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:
- deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
  - ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurive;*
  - nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
  - nuk ka kryer deklaratim të rremë;*
  - subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*
15. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.
16. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuara nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

### **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

#### **1. Apartament me sipërfaqe 82.9 m<sup>2</sup>, i ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë**

1. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2003<sup>2</sup> pasurinë e llojit apartament banimi me sipërfaqe 85 m<sup>2</sup>, i ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, ap. \*\*\*, pallatet \*\*\* në Tiranë, në vlerën 3.200.000 lekë, në bashkëpronësi në masën 50% të saj. Kjo pasuri është porositur nga bashkëshorti i subjektit, z. A. G., me anë të kontratës nr. \*\*\*, datë 14.1.2000, me shoqërinë “\*\*\*\*”, sh.p.k<sup>3</sup>.

<sup>2</sup> Para fillimit të detyrës, Inspektore gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë.

<sup>3</sup> Bashkëlidhur kontratës ka rezultuar një dokument “Akt mbarim kontrate”, pa datë apo vit të përcaktuar certifikatën e pronësisë së pasurisë, datë 28.4.2016, si dhe 4 kontrata sipërmarrjeje nga shoqëria e sipërcituar, bashkëlidhur të cilave gjendeshin dokumentet “Akt mbarim kontrate”, të cilat po ashtu rezultuan pa datë dhe pa vit të përcaktuar.

2. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar apartamentin në analizë në vlerën 23.500 USD. Si burim për krijimin e kësaj pasurie subjekti ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e një apartamenti në Shkodër<sup>4</sup>, si dhe kursimet familjare ndër vite.
3. Në vijim, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar si burim krijimi për këtë pasuri edhe të ardhurat e përfituara nga shitja e një automjeti që bashkëshorti i saj ka pasur në pronësi.
4. Gjatë hetimit të kryer nga Komisioni, ASHK Tiranë Jug<sup>5</sup> ka përcjellë dosjen e pasurisë në analizë, si dhe është bërë me dije se në dosjen e legalizimit nuk disponoheshin fatura të pagesave të kryera ndaj shoqërisë ndërtuese/sipërmarrëse.
5. Nga FSHU-ja<sup>6</sup> dhe UKT-ja<sup>7</sup> janë konfirmuar kontrata të lidhura në emër të z. A. G., në datën 18.4.2002. Sipas të dhënave të kontratave, ka rezultuar se ato i përkasin pasurisë në analizë.

### **1.1 Lidhur me analizimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie**

6. Subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2003, si dhe në deklaratën *Vetting*, si burim krijimi për blerjen e kësaj pasurie: (i) të ardhurat nga shitja e apartamentit të përfitur me autorizim nga Bashkia Shkodër; në shumën 1.000.000 lekë; (ii); kursimet familjare ndër vite; në vijim në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar si burim edhe (iii) të ardhurat nga shitja e automjetit në vlerën 600.000 lekë.

#### **1.1.1 Lidhur me burimin e të ardhurave nga shitja e apartamentit në Shkodër**

7. Apartamenti i ndodhur në lagjen “\*\*\*\*” në Shkodër është përfitur nga subjekti dhe bashkëshorti i saj me anë të autorizimit<sup>8</sup> (deri në përfundim të ndërtimit) datë 11.9.1995, nga Bashkia Shkodër<sup>9</sup>.
8. Nga ASHK Shkodër<sup>10</sup> është bërë me dije se nuk kanë rezultuar pasuri të regjistruara në emër të subjektit apo familjarëve të saj.
9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti kanë nënshkruar deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 26.4.1999, me z. V. F., për shitjen e apartamentit në Shkodër në shumën 1.000.000 lekë. Në këtë deklaratë, ndër të tjera, është cituar se pala blerëse V. F. do të kryente procedurën e privatizimit të apartamentit në emër dhe për llogari të shitësve deri në shlyerjen e plotë të të gjitha kësteve që lidheshin me privatizimin e pronës. Blerësi ka marrë përsipër kryerjen e aktit përfundimtar pranë noterisë dhe regjistrimin e pronës në ZVRPP në emër të shitësve P. e A. Gruda. Pas privatizimit dhe regjistrimit të pronës, pala shitëse do të formalizonte me kontratë me blerësin V. F. shitjen e kësaj pasurie. Në deklaratë citohet gjithashtu se palët nuk kanë

<sup>4</sup> Znj. Gruda dispononte me autorizim apartamentin e ndodhur në Shkodër, të cilin ajo dhe bashkëshorti e kanë shitur në vitin 1999.

<sup>5</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 3.12.2020, shkresa nr. \*\*\* prot., datë 22.11.2017 dhe shkresa nr. \*\*\* prot., datë 16.5.2023.

<sup>6</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2021.

<sup>7</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 20.5.2023.

<sup>8</sup> Në këtë autorizim citohet se: Komisioni i Strehimit të Bashkisë ka vendosur që: “*Qytetari Pranvera Gruda të sistemohet në pallatin e ndodhur në rajonin \*\*\*, në Shkodër; në apartament banimit të përbërë nga 2 dhoma e kuzhinë, kati i dytë që ndërtohet në vitin 1995. Sistemimi në pallat do të bëhet pasi të përfundojë ndërtimi i plotë dhe konform rregullave. Në të kundërt, bashkia ka të drejtën e shfuqizimit të këtij autorizimi*”. Gjithashtu, në autorizimin e sipërcituar gjendet shënimi i datës 21.10.1996, me shkrim dore: “*VO. Autorizimi është në emër të Pranvera Gruda*”.

<sup>9</sup> Nga Bashkia Shkodër është bërë me dije se nuk disponohej praktika e privatizimit të banesës në fjalë.

<sup>10</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.8.2023.

detyrime të pashlyera ndërmjet tyre. Deklarata është nënshkruar nga subjekti, bashkëshorti i saj dhe z. V. F.

10. Po në të njëjtën datë, me anë të një prokure të posaçme me nr. 1181/417, datë 26.4.1999, subjekti dhe bashkëshorti kanë autorizuar z. Franja për t'i përfaqësuar pranë Entit Kombëtar të Banesave lidhur me procedurën e privatizimit të apartamentit në analizë.
11. Subjekti ka bashkëlidhur në deklaratën *Vetting* kallëzimin e bërë prej saj në vitin 2011 lidhur me falsifikimin e kontratës së shitblerjes datë 17.10.2001, nga z. F.<sup>11</sup>.
12. Duke qenë se shitja e pasurisë në Shkodër ka shërbyer si burim për likuidimin e pjesëshëm të çmimit të blerjes së pasurisë apartament banimi në Tiranë dhe është deklaruar në deklaratën *Vetting*, Komisioni ka verifikuar: (i) legjitimitetin e fitimit të pronësisë; (ii) ligjshmërinë e shumës 1.000.000 lekë, të përdorur për krijimin e pasurisë në analizë.
13. Nisur nga sa më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqesë shpjegime lidhur me procedurën e përfitimit të pasurisë apartament në Shkodër dhe të shitjes së saj tek persona të tretë, si dhe ligjshmërinë e krijimit të shumës së përfituar – duke paraqitur dokumentet ligjore përkatëse. Po ashtu, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqiste shpjegime bindëse lidhur me legjitimitetin dhe etikën e procedurave dhe të veprimeve të mësipërme, si dhe mbi pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

14. Subjekti ka parashtruar se bashkëshorti i saj ka qenë trashëgimtar i një pasurie të ndodhur në Shkodër, në bashkëpronësi, sipas dëshmisë së trashëgimisë së babait të tij të vitit 1994. Në këtë vit, ndonëse bashkëshorti i subjektit ishte trashëgimtar, pasuria në fjalë figuronte ende në emrin e të ndjerit, pasi ende nuk ishte bërë pjesëtimi i saj mes bashkëtrashëgimtarëve. Kjo për shkak se prona ka qenë objekt konflikti gjyqësor, në përfundim të të cilit, z. Gruda, me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.12.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka dorëzuar pronën.
15. Në vijim, pas kërkesës në cilësinë e familjes së pastrehë, me autorizimin e datës 11.9.1995 Komisioni i Strehimit të Bashkisë Shkodër e ka pajisur subjektin dhe bashkëshortin e saj me autorizim për sistemimin në një pallat, i cili ishte ende në ndërtim. Subjekti ka paraqitur vendimin nr. \*\*\*, datë 14.10.1999, “Për dhënie statusi si të pastrehë”, në të cilin citohet se: “*Këshilli Bashkiak Shkodër, mbështetur në VKM-në nr. 250, datë 16.4.1996, “Për procedurat dhe prioritetet në zbatim të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”*”... ka vendosur... 2. T'i japë statusin e të pastrehit Grupi B, personave që ndodhen në listën 1 bashkëngjitur këtij vendimi...” dhe në numrin rendor \*\*\*, gjendet edhe emri i subjektit të rivlerësimit Pranvera Gruda.
16. Lidhur me shitjen e pasurisë në fjalë, subjekti ka parashtruar se dokumenti i nënshkruar me z. F. përfaqëson një “Deklaratë” dhe jo shitje dhe as kalim të së drejtës së pronësisë

<sup>11</sup> Në kallëzimin penal të bërë nga subjekti regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2017, subjekti ka pretenduar se kontrata e shitblerjes e datës 24.11.2000, nënshkruar mes Drejtorisë Rajonale të Entit të Banesave Shkodër dhe shtetasve H. G., A. G., P. G., P. G. dhe G. G., është e falsifikuar. Në lidhje me këtë kallëzim, Prokuroria ka vendosur *Pushimin e çështjes penale*. Në vijim, vendimi i pushimit është shfuqizuar më 3.12.2012 nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Më pas, me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.11.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2011, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal.

(shitje me kusht). Vetëm pas privatizimit dhe regjistrimit të kësaj prone në zyrën e regjistrimit, do të bëhej edhe akti përfundimtar, kontrata e shitjes ndërmjet shtetasve A. e Pranvera Gruda me z. V. F., i cili ka rënë dakord me kushtet e kësaj deklarate duke e firmosur atë.

17. Duke qenë se nuk ishte përfunduar procedura ligjore dhe kryerja e pagesave përkatëse nga ana e blerësit të autorizuar për kryerjen e tyre, për rrjedhojë, subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë mundur të paguajnë tatimin mbi këtë pronë. Subjekti ka sqaruar se ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të kontaktuar me blerësin e kësaj pasurie, me qëllim finalizimin e kalimit të pronësisë, por kontakti me të ka qenë i pamundur, pasi ai ndodhet jashtë vendit dhe në atë banesë nuk banon asnjëri.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

18. Trupi gjykues, pasi analizoi prapësimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe provat e paraqitura prej saj, dokumentacioni ligjor lidhur me procedurën e privatizimit të banesës, në cilësinë e familjes së pastrehë, duket bindës, për më tepër që kjo e drejtë ishte kristalizuar edhe nga vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 1.12.1994. Me anë të këtij vendimi gjykata kishte vendosur: *“Detyrimin e palës së paditur, z. A. G., për lirim të një sipërfaqeje banimi 2+1, pasi të paditurit t’i sigurohej një sipërfaqe e njëjtë banimi nga Këshilli i Bashkisë, i cili duhet të trajtonte me përparësi z. G. për strehim”*. Pas përfundimit të proceseve gjyqësore e administrative, me kërkesë të bashkëpronarëve, nga ZRVPP Shkodër është nxjerrë certifikata e pronësisë, datë 1.2.2013<sup>12</sup>, sipas së cilës bashkëshorti i subjektit ka rezultuar bashkëpronar në masën 1/6 pjesë e pasurisë.
19. Gjithashtu, ka rezultuar se në vitin 1995, subjekti dhe bashkëshorti i saj janë pajisur me autorizim për strehim, bazuar në vendimin e Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 139, datë 14.10.1999, *“Për dhënien e statusit të të pastrehit”*<sup>13</sup>, sipas ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995. Bazuar në nenin 12/4 të këtij ligji, parashikohet se: *“Nuk përfitojnë nga ky ligj familjet e pastreha, në të cilat qoftë edhe një anëtar i tyre: ... 4. Ka në pronësi banesë jo më të vogël se normat e strehimit të familjes së tij të pastrehë”*. Gjithsesi, duke qenë se familja e subjektit përbëhej nga katër anëtarë, konstatohet se sipërfaqja që do t’i takonte pas ndarjes së pasurisë së disponuar nga bashkëshorti nga trashëgimia (në masën 1/6 pjesë e saj) nuk ishte e mjaftueshme për banim, referuar përcaktimeve të ligjit të cituar më sipër.
20. Nisur nga sa më lart, vlerësohet se autorizimi që i është dhënë subjektit dhe bashkëshortit të saj nga Komisioni i strehimit është një akt që i ka paraprirë kontratës së shitjes së apartamentit, që do të realizohej në një moment të dytë kur edhe do të përlllogaritej pagesa e çmimit të shitjes sipas VKM-së nr. 291, datë 21.6.1995 dhe të VKM-së nr. 453, datë 21.8.1995.
21. Për sa i përket shitjes së pasurisë në fjalë, referuar nenit 750 të Kodit Civil, përcaktohet se: *“Shitja e sendeve të paluajtshme kryhet sipas mënyrave të parashikuara në nenin 83 të këtij Kodi, përndryshe është e pavlefshme”*. Ndërkohë, referuar nenit 83, përcaktohet se: *“Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave*

<sup>12</sup> Bashkëshorti i subjektit është paditur nga ish-pronarët, trashëgimtarët e xhaxhait të bashkëshortit të subjektit, që kanë në pronësi pjesën tjetër të së njëjtës banesë me atë të vjehrrit të subjektit, të ndjerit H. G., për marrjen e pronës.

<sup>13</sup> Akt që bashkëngjitur ka listën e personave që përfitojnë statusin e të pastrehit Grupi B ku, ndër të tjerë, pasqyrohet edhe emri i znj. Pranvera Gruda.

*reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm”.*

22. Deklarata e nënshkruar mes palëve nuk është konsideruar si akt shitjeje as nga subjekti, por nuk konsiderohet e tillë as në kuptim të dispozitave të Kodit Civil. Trupi gjykues çmon se kjo deklaratë përbën një marrëdhënie atipike/veprim juridik me kusht. Në kuptim të neneve 84-88 të Kodit Civil, lindja ose shuarja e të drejtave dhe e detyrimeve të parashikuara në veprimin juridik me kusht varen nga një ngjarje që nuk dihet nëse dhe kur do të ndodhë. Pasojat që lidhen me vërtetimin e kushtit fillojnë nga çasti që është vërtetuar kushti. Deklarata në këtë rast është një kontratë paraprake konsensuale, që ka për qëllim transferimin e të drejtës së pronësisë në një moment të dytë. Objekti i saj është pikërisht pagesa e një shume të caktuar të hollash përkundrejt përfitimit të të drejtave pasurore mbi një send (banesë), që ndonëse ekziston materialisht në momentin e nënshkrimit të deklaratës, nuk është në pronësi, por ende nën procedurën e regjistrimit, ndonëse *in interim* në përdorim të palës shitëse me të drejta reale të pritshme (si më sipër). Kësisoj, marrëdhënia juridike e krijuar ndërmjet palëve kontraktore është një marrëdhënie juridiko-civile, e cila materializohet në momentin e realizimit të kushtit. Momenti i fitimit të së drejtës së pronësisë së garantuar nga kjo kontratë fillon pasi shitësi të bëhet pronar *de jure* i apartamentit dhe e transferon të drejtën e tij të pronësisë.
23. Gjithashtu, duke vijuar në një vlerësim plotësues të kësaj rrethane, vlen të analizohet qëllimi real i kontratës *de qua*, bazuar në përmbajtjen e dispozitës së nenit 681 të Kodit Civil, i cili përcakton se: “Kur interpretohet një kontratë duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës”. Në rastin konkret, qëllimi ka qenë fitimi i pronësisë së sendit në të ardhmen nga z. F., pas plotësimit të kushtit, për të cilin palët kishin renë dakord, si dhe për të cilin ky shtetas kishte parapaguar çmimin përkatës.
24. Në lidhje me legjitimitetin e të ardhurave të realizuara nga shitja, trupi gjykues ka analizuar detyrimin e subjektit sa i takon pagesës së tatimit të të ardhurave, në referencë të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 29, datë 30.7.2018. Konkretisht, në nenin 11, pika 1 e këtij ligji, parashikohet se: “1... Individu që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme paguan tatimin para kryerjes së regjistrimit të aktit të kalimit të pasurisë, në përputhje me aktet dhe procedurat ligjore në fuqi...”. Në rastin konkret, në referencë të legjislacionit të kohës, në momentin e nënshkrimit të deklaratës, si dhe tipologjisë së saj dhe në pamundësi të regjistrimit të pronës në emër të blerësit konstatohet mospasja e detyrimit për pagesën e tatimit mbi të ardhurat në atë fazë (për sa kohë kjo pasuri nuk ishte regjistruar ende në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme). Ndërkohë që, vonesa në regjistrimin e kësaj pasurie nuk ka ardhur për faj apo neglizhencë të subjektit. Rrjedhimisht, vetëm në këtë moment (të plotësimit të kushtit *sine qua non*) do të materializohet detyrimi *de jure* (ndërkohë i pezulluar nga kushti) dhe do të mundësohet edhe *de facto* pagesa e detyrimeve tatimore që mbartej nga pala shitëse. Në këto kushte nuk evidentohen shkelje apo mospërmbushje të detyrimeve tatimore nga subjekti.
25. Në përfundim, trupi gjykues çmon se duke pasur në konsideratë rrethanat dhe provat



lidhur me marrjen e shumës 1.000.000 lekë, si dhe faktin se kjo shumë nuk është përfituar përmes një kontrate të mirëfilltë shitjeje, por përmes një akti për premtimin e shitjes me kusht nuk u konstatuan problematika mbi ligjshmërinë e përfitimit (*pro tempore*) dhe përdorimin e kësaj shume si burim të ligjshëm në investimin e mëpasshëm.

### 1.1.2 Lidhur me kursimet familjare ndër vite

26. Në DIPP-në e vitit 2003, si dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si një ndër burimet e krijimit të pasurisë në analizë, kursimet familjare ndër vite, por pa përcaktuar një shumë konkrete të tyre. Në vijim, në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar se kursimet janë realizuar nga: (a) të ardhurat nga paga e saj; (b) të ardhurat e bashkëshortit; (c) të ardhurat nga pensioni i vjehrrit të saj në shumën 80.000 lekë.

#### a) Lidhur me të ardhurat dhe kursimet e subjektit

27. Lidhur me të ardhurat nga paga për periudhën 1989 – janar 1992, Komisioni iu referua vendimit nr. 15-2021 (JR), datë 18.6.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit ku, ky i fundit, në funksion të një qëndrimi orientues sipas parashikimit të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashtroi: “ [...] *periudha kohore para ndryshimeve demokratike në vend që përkon me vitet 1991 – 1992, nuk mund të jetë si rregull një periudhë, e cila mund të llogaritet në funksion të përcaktimit të ndonjë vlere të kursyer, për shkak të një realiteti të jetuar që ka provuar se monedha zyrtare, leku, në këtë periudhë pësoi një inflacion në nivele shumë të larta e të jashtëzakonshëm, produkt i ndryshimeve politike, sociale dhe ekonomike në vend që e bën të pabesueshme dhe të palogjikshme mundësinë potenciale të kursimit nga të ardhurat nga puna në këto periudha. Për pasojë, pasi monedha vendase hyri në një fazë stabiliteti, pas viteve 1992 – 1993, mundësia për të kursyer mund të konsiderohet si opsion.. [...]”.*

28. Nga Ministria e Drejtësisë<sup>14</sup> është bërë me dije se subjekti gjatë vitit 2001 ka realizuar të ardhura në shumën 9.110 lekë, ndërsa për vitin 2002 ajo ka realizuar shumën 89.324 lekë. Komisioni, në referencë të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji<sup>15</sup>, në përlllogaritjen e të ardhurave të përfituara nga subjekti sipas dokumentacionit të paraqitur nga Ministria e Drejtësisë, nuk ka përfshirë dietat e përfituara nga subjekti.

29. Referuar dokumentacionit të përcjellë nga universiteti “\*\*\*”<sup>16</sup>, Shkodër, ka rezultuar se subjekti për vitet 1995 – 1996 ka përfituar 82.802 lekë, shumë që u provua me dokumentacion ligjor.

#### b) Lidhur me të ardhurat dhe kursimet e bashkëshortit të subjektit

30. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. \*\*\*, datë 2.2.2021, nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, ku citohet se z. G. ka ushtruar e profesionin e avokatit prej vitit 2001 deri në vitin 2007 e në vijim ka kaluar më status pasiv. Gjithashtu, ajo ka deklaruar se bashkëshorti i saj ka realizuar të ardhurat si vijon:

- i. Të ardhurat nga paga si mësues për periudhën 1993 – 1996, në shumën 187.885 lekë, sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 22.11.2016, të ISSH-së.

<sup>14</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.10.2016.

<sup>15</sup> Vendimi nr. 7/2019.

<sup>16</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.11.2016, si dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021.

- ii. Të ardhurat nga punësimi si kuzhinier pranë aktivitetit bar-restorant në Shkodër të z. D. K., në vitet 1996 – 1999, të cilin e kanë paguar rregullisht në shumën 30.000 lekë, por nuk ka paguar sigurime shoqërore për të punësuarit, për shkak të kohës. Në këto kushte, të ardhurat në fjalë nuk janë konsideruar në analizën financiare, për sa kohë nuk u provua ligjshmëria e tyre.
  - iii. Të ardhurat sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër<sup>17</sup> lidhur me të ardhurat e përfituara nga ekzekutimi i vendimit të Gjykatës dhe shkresën e Drejtorisë së Përmbaramit Tiranë<sup>18</sup>, për shumën 188.050 lekë nga ekzekutimi i këtij vendimi.
  - iv. Të ardhurat si konsulent në shoqërinë “\*\*\*”, pa kontratë prej vitit 2000 deri në vitin 2004, ku është paguar prej tyre 1 herë në 3 muaj si i punësuar me kohë të pjesshme<sup>19</sup>. Lidhur me këto të ardhura, nga DRT Tiranë<sup>20</sup> nuk janë konfirmuar pagesa të kryera nga shoqëria në fjalë për periudhën tatimore 2000 – 2004. Për rrjedhojë, këto të ardhura nuk janë përfshirë në analizën financiare.
  - v. Të ardhurat nga ushtrimi i profesionit të avokatit për periudhën 2001 – 2007 kanë qenë në vlerën rreth 1.682.740 lekë. Ndonëse subjekti ka pretenduar se bashkëshorti ka realizuar të ardhura pas vitit 2007, referuar dokumentacionit të administruar nga Komisioni si dhe atij<sup>21</sup> të paraqitur nga subjekti, Komisioni, duke marrë në konsideratë se: (i) bashkëshorti i subjektit ka qenë i licencuar për ushtrimin e profesionit avokat gjatë periudhës 2001 – 2007, më pas licenca e tij ka kaluar me status pasiv; (ii) subjekti nuk provoi që bashkëshorti i saj të ketë paguar detyrime tatimore për të ardhurat e realizuara nga avokatia – për rrjedhojë, ka konsideruar në analizën financiare vetëm të ardhurat për periudhën 2001 – 2007<sup>22</sup>. Nga DPT-ja<sup>23</sup> janë paraqitur të dhënat nga sistemi tatimor për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar se të dhënat i përkasin periudhës nga viti 2012 e në vijim.
  - vi. Të ardhurat nga mësimdhënia pranë universitetit “\*\*\*”, për periudhën 2007 – 2011, në shumën 1.683.676 lekë, sipas vërtetimit të datës 10.1.2017. Këto të ardhura janë përfituar nëpërmjet bankës.
  - vii. Të ardhurat nga paga si specialist pranë ATP-së, për periudhën 2012 – 2016, sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2017.
- 31.** Në analizë të sa më sipër, referuar qëndrimin orientues në vendimin nr. 15-2021 (JR), datë 18.6.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si dhe bazuar në nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nga Komisioni nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit të saj për vitet 1989 – 1992. Pavarësisht shpjegimeve të subjektit se në vitet

<sup>17</sup> Vendimi nr. \*\*\* akti i vitit 11.9.1997.

<sup>18</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 6.1.2021.

<sup>19</sup> Subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 10.2.2021, të shtetasve P. dhe A. K.

<sup>20</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.6.2023.

<sup>21</sup> Subjekti ka paraqitur vërtetimin e datës 19.1.2017, si dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.12.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për disa të ardhurat e përfituara gjatë ushtrimit prej tij të profesionit të avokatit i caktuar kryesisht; shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas së cilës rezultoi se ai ka përfituar pagesa si avokat kryesisht që në vitin 2001 deri në vitin 2007.

<sup>22</sup> Të ardhurat në fjalë për periudhën nga viti 2005 e në vijim, z. G. i ka marrë nëpërmjet bankës.

<sup>23</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.5.2021, Komisioni iu drejtua Bashkive Shkodër dhe Tiranë, të cilat në kthim përgjigjet e tyre kanë bërë më dije se nga verifikimi i sistemit të integruar të taksave dhe tarifave vendore ka rezultuar se nuk figuron i regjistruar si tatimpagues/aktivitet tregtar z. A. G.

1996 – 1999 nuk i është kushtuar vëmendje pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe paga merrej në arkën e shoqërisë dhe jo nëpërmjet sistemit bankar, Komisioni nuk i ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat e bashkëshortit të subjektit për periudhën në fjalë, për sa kohë nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion provues për realizimin e këtyre të ardhurave apo për pagesën e detyrimeve tatimore/kontribuuese përkatëse.

*c) Lidhur me të ardhurat nga depozita në ish-Bankën e Kursimeve, nga vjehri i subjektit*

32. Në pyetësin nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar si burim për blerjen apartamentit edhe të ardhurat e vjehrit të saj<sup>24</sup>. Në vijim, në përgjigje të pyetësit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se të ardhurat nga pensioni i vjehrit të saj kanë qenë në shumën 80.000 lekë, të cilën e dispononte në ish-Bankën e Kursimeve. Pasi vjehri ka ndërruar jetë, bashkëshorti i subjektit, në bazë të dëshmisë së trashëgimisë nr. \*\*\*, datë 23.2.1994, ka tërhequr shumën në fjalë. Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka paraqitur dokumentin nr. \*\*\* prot., datë 11.1.2021, të Raiffeisen Bank, ku shpjegohet se nga verifikimi nuk janë gjetur të dhëna për depozitë kursimi në emër të shtetasit H. G., pasi një pjesë e dokumentacionit është djegur pas vitit 1997. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur edhe një deklaratë noteriale me nr. \*\*\*, datë 1.2.2021, në të cilën motrat e z. A. G. kanë deklaruar se kanë autorizuar vëllain e tyre që pas çeljes së trashëgimisë të tërhiqte shumën 80.000 lekë dhe t'i përdorte në favor të familjes së tij, duke qenë se ai ishte kujdesur për babain. Po në këtë pyetësor, subjekti ka paraqitur një vërtetim nga sigurimet shoqërore me nr. \*\*\*, datë 16.9.2020, për të ardhurat e vjehrit nga pensioni për harkun kohor 1.8.1992 – 18.2.1994, në shumën totale 30.273 lekë.
33. Për sa më sipër, ndonëse nuk ka ndonjë impakt në analizën e përgjithshme financiare për vitin 2000, për një vlerësim gjithëpërfshirës të pretendimeve të subjektit, Komisioni – duke pasur në konsideratë: (i) shumën e këtyre të ardhurave në vlerën 80.000 lekë; (ii) origjinën e tyre, ku 1/3 është përfituar nga bashkëshorti i subjektit nga trashëgimia e babait të tij, ndërsa pjesa tjetër prej 2/3 i është dhuruar nga motrat e tij sipas deklaratës noteriale të cituar më sipër, e cila konsiderohet me vlerë provuese në raport me dorëheqjen nga pjesa takuese, megjithëse është e vitit 2021, duke pasur parasysh marrëdhënien e posaçme motër-vëlla me bashkëshortin e subjektit; (iii) përgjigjen e bankës ku bëhet me dije se dokumentacioni është djegur – konstaton se, për rrjedhojë, subjekti ka qenë në pamundësi objektive për të provuar me dokumentacion ligjor ekzistencën e të ardhurave në fjalë. Në këto kushte, bazuar në deklaratimet e subjektit në pyetësorët e dërguar nga Komisioni, është përlogaritur mundësia potenciale e subjektit për të kursyer nga të ardhurat nga paga e saj dhe e bashkëshortit për periudhën 1993 – 2000, duke përfshirë në analizën financiare edhe shumën 80.000 lekë të tërhequr nga bashkëshorti në datën 18.2.1994 (ndonëse pa impakt përcaktues), siç është paraqitur në mënyrë të detajuar në tabelën në vijim.

**Tabela nr. 1** – Analiza e mundësisë financiare të subjektit dhe bashkëshortit për të kursyer deri në fund të vitit 2000

<sup>24</sup> Sipas dokumentit dëshmi trashëgimie e datës 23.2.1994, i ndjeri H. G. ka vdekur në datën 18.2.1994.

Te ardhura nga paga e subjektit 1993-31.12.2000	2,293,496
Te ardhura nga paga e b/shortit 1993-31.12.2000	187,885
Te ardhura nga shitja e automjetit	500,000
Te ardhurat nga kursimet e vjehrrit	80,000
Te ardhura nga shitja e prones ne Shkoder	1,000,000
Te ardhura nga Vendimi i Gjykates se Rrethit Tirane	188,050
Shpenzime jetese 1993-31.12.2000	(1,101,198)
Shpenzim per blerje automjeti 1998	(500,000)
<b>Rezultati në datë 31.12.2000</b>	<b>2,648,233</b>

34. Për sa më sipër, subjekti ka rezultuar me mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për realizimin e kursimeve për periudhën 1993 – 2000.

### 1.1.3 Lidhur me të ardhurat nga shitja e automjetit

35. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për krijimin e pasurisë apartament edhe të ardhurat nga shitja e një automjeti në vitin 1998. Në mbështetje të deklarimit të saj, subjekti ka paraqitur kontratën e blerjes së automjetit, datë 6.11.1998, në vlerën 500.000 lekë, nga pala shitëse E. D. Në vijim, me anë të kontratës datë 23.11.1999, kjo pasuri është shitur nga bashkëshorti i saj në shumën 600.000 lekë shtetasit H. Th.

36. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 lidhur me mosdeklarimin e këtij burimi në DIPP-në e vitit 2003, subjekti ka shpjeguar se prej saj ka qenë thjesht një harresë mosdeklarimi i këtij burimi. Bashkëlidhur ka vënë në dispozicion edhe kontratat e shitblerjes së automjetit në fjalë, dokumentacion që konfirmohet edhe nga DPSHTRR-ja Tiranë.

37. Gjatë hetimit të kryer nga Komisioni nuk rezultoi që subjekti të ketë kryer ndonjë investim në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, për të cilat mund të ishin përdorur të ardhurat nga shitja e automjetit në fjalë. I vetmi investim i kryer në harkun kohor të shitjes së këtij automjeti ka qenë blerja e apartamentit në analizë. Për rrjedhojë, ndonëse subjekti nuk i ka deklaruar si burim këto të ardhura as në deklaratën periodike e as në deklaratën *Vetting*, duke marrë në konsideratë faktet si vijon: (i) shitja e automjetit është bërë në vitin 1999, rreth 4 vjet përpara sesa subjektit t'i lindte detyrimi për deklarim; (ii) bazuar në legjislacionin e kohës, ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", nuk parashikohej që për këto lloj të ardhurash të paguhej tatim; (iii) diferenca relativisht e vogël mes çmimit të blerjes dhe çmimit të shitjes, prej 100.000 lekësh; (iv) shpjegimi i subjektit në pyetësorin nr. 2 se këto të ardhura i ka disponuar *cash* së bashku me kursimet familjare – trupi gjykues çmon se qëndron pretendimi i subjektit se ato janë përdorur për blerjen e apartamentit dhe, për rrjedhojë, janë përfshirë në analizën financiare. Gjithsesi, trupi gjykues ka vlerësuar të konsiderojë të ardhurat nga kjo shitje në masën 500.000 lekë, për sa kohë nuk është provuar shkak i shitjes më shumë sesa mjeti është blerë – rrethanë kjo që bie ndesh me logjikën ekonomike të tregut.

38. Për sa më sipër, Komisioni ka kryer analizën financiare të burimeve të krijimit të pasurisë në analizë, referuar deklarimit të subjektit në DIPP-në e viteve 2003 e 2004, në deklaratën *Vetting*, si dhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, për periudhën 1993 – 2002, duke konsideruar: (i) të ardhurat nga paga të subjektit dhe bashkëshortit të saj ndër vite; (ii) të ardhurat nga shitja e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme; (iii) shpenzimet

jetike; (iv) shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit; (v) investimin në këtë apartament, të cilat janë paraqitur në tabelën në vijim:

**Tabela nr. 2** – Analiza e burimeve për blerjen e automjetit në datën 6.11.1998

Te ardhura nga paga e subjektit 1993-6.11.1998	1,349,801
Te ardhura nga paga e b/shortit 1993-6.11.1998	187,885
Shpenzime jetese 1993-6.11.1998	(528,944)
Blerje automjeti 1998	(500,000)
<b>Rezultati në datë 6.11.1998</b>	<b>508,742</b>

39. Nga sa më sipër ka rezultuar se subjekti ka pasur burime të ligjshme, të mjaftueshme për krijimin e pasurisë automjet.

### 1.2 Lidhur me pagesën e kështit të parë të apartamentit

40. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka shpjeguar se ndonëse është përpjekur të kontaktojë me shoqërinë ndërtuese, nuk ka mundur të sigurojë mandatpagesat/faturat e paguara për blerjen e apartamentit në pronësi të tij.

41. Në vijim, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se fillimisht nga ana e bashkëshortit të saj janë paguar 3.000 USD në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së apartamentit dhe se kryerja e plotë e pagesës ka përfunduar në fund të vitit 2002 – kur edhe kanë nisur të jetojnë në këtë apartament.

42. Për sa më sipër, Komisioni ka kryer analizën financiare për pagesën e shumës 3.000 USD në datën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 14.1.2000.

43. Nga analiza e kryer ka rezultuar se subjekti ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e pagesës në fjalë, siç paraqitet në tabelën në vijim.

**Tabela nr. 3** – Analiza e burimeve për pagesën e shumës 3.000 USD, në datën 14.1.2000

Të ardhura nga paga e subjektit	2,293,496
Të ardhura nga paga e b/shortit	187,885
Te ardhurat nga kursimet e vjehrrit	80,000
Të ardhura nga shitja e automjetit	500,000
Të ardhura nga shitja e pronës në Shkoder	1,000,000
Të ardhura nga Vendimi i Gjykatës së Rrethit Tiranë	188,050
Shpenzime jetese	(1,101,198)
Shpenzim për blerje automjeti	(500,000)
Blerje apartament banimi në Tiranë	(439,602)
<b>Rezultati</b>	<b>2,208,631</b>

44. Nga sa më sipër ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për pagesën e kështit të parë prej 3.000 USD.

### 1.3 Lidhur me pagesën e kështit të dytë të apartamentit

45. Nisur nga fakti se përgjatë hetimit nuk ka rezultuar një kontratë e mirëfilltë shitjeje, por një dokument “Akt mbarim kontrate” pa datë apo vit të përcaktuar, bazuar në konstatimet e arritura gjatë hetimit administrativ (referuar të dhënave të kontratës për furnizimin me energji elektrike etj.), si dhe bazuar në deklaratimet e subjektit lidhur me marrjen në dorëzim të apartamentit dhe fillimin e përdorimit të tij, Komisioni ka kryer analizën financiare për periudhën kohore 1.1.2001 – 18.4.2002 (në stadin aktual, duke e konsideruar me rezervë shumë prej 1.000.000 lekësh, të trajtuar më sipër).

**Tabela nr. 4** – Analiza e burimeve për pagesën e shumës 20.500 USD, në datën 18.4.2002

Të ardhura nga paga e subjektit	576,393
Të ardhura nga paga e b/shortit	241,250
Të ardhura nga viti paraardhës	2,208,631
Shpenzime jetese	(497,592)
Blerje apartament banimi në Tiranë	(2,769,235)
<b>Rezultati</b>	<b>(240,553)</b>

46. Në përfundim të analizës së kryer, subjekti ka rezultuar me një pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për pagesën e kështit të fundit për blerjen e apartamentit, në masën -240.553 lekë.
47. Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të dhënë shpjegime bindëse, si dhe për të paraqitur dokumentacionin ligjor për të provuar të kundërtën e rezultateve të Komisionit lidhur me problematikat e konstatuara për pasurinë në fjalë.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

48. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ky rezultat është pasojë e mosmarrjes në konsideratë të të ardhurave nga punësimi i bashkëshortit si kuzhinier pranë aktivitetit “bar-restorant” në Shkodër, të shtetasit D. K., për vitet 1996 – 1999, si dhe punësimi si konsulent në shoqërinë “\*\*\*” për vitet 2000 – 2004. Pavarësisht se nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore, subjekti ka pretenduar që të bëhet një balancim me shpenzimet e jetesës përgjatë kësaj periudhe.
49. Lidhur me të ardhurat nga shitja e automjetit, subjekti ka pretenduar të konsiderohet shitja e tij në vlerën 600.000 lekë, referuar kontratës së shitjes, duke mbajtur në konsideratë se shitja ka ndodhur pas 1 viti në qytetin e Tiranës, një treg komplet ndryshe nga ai i Shkodrës, ku çmimet janë më të larta.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

50. Trupi gjykues, pas analizimit të prapësimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në referencë edhe të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji<sup>25</sup>, vlerëson se pavarësisht se palët janë të lira të përcaktojnë çmimet e shitjes dhe pavarësisht se nuk ka çmime reference (detyruese) për shitblerje automjetesh, shitja e këtij automjeti në vlerë më të lartë është jashtë logjikës, sipas së cilës një mjet që përdoret amortizohet. Në këto kushte, pretendimi i subjektit për përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave nga shitja e automjetit në shumën 600.000 lekë nuk qëndron, për sa kohë subjekti nuk paraqiti ndonjë dokumentacion që do të provonte rritjen e vlerës së automjetit në masën e pretenduar nga subjekti.
51. Në lidhje me pretendimin e subjektit për përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave të bashkëshortit të përfituara nga puna në të zezë, trupi gjykues e gjen këtë pretendim të pabazuar në ligj e në prova. Referuar nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të (bashkëshorti në rastin konkret), së bashku me deklaratën e pasurisë paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë

<sup>25</sup> Vendimi nr. 34, datë 2.12.2019, pg. 63.5.

e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Pra, kjo dispozitë ligjore e ngarkon subjektin e rivlerësimit të deklarojë saktë pasurinë për personat e lidhur, bashkëshortin etj. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u provuan nga subjekti i rivlerësimit ligjërisht të ardhurat e pretenduara të bashkëshortit, edhe pse iu dha mundësia për t'i paraqitur ato. Megjithatë, trupi gjykues çmon se edhe nëse do të merreshin në konsideratë të ardhurat e pretenduara nga subjekti, gjithsesi ato nuk do të kishin ndonjë efekt përcaktues në vendimmarrjen e Komisionit, duke pasur parasysh masën e balancës negative.

## 2. Automjet tip “Renault Megane”, blerë në vlerën 250.000 lekë

52. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* pasurinë e llojit automjet, të përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 18.9.2006, nga shitësi E. T., në vlerën 250.000 lekë. Komisioni e ka ftuar subjektin nëpërmjet pyetësorit nr. 2 të bënte me dije mbi burimin e krijimit të kësaj pasurie, duke qenë se ajo nuk e kishte deklaruar burimin në deklaratën *Vetting*. Në përgjigje të këtij pyetësi, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet nga punësimi për vitet 2005 – 2006.
53. Sipas verifikimit në sistemin e AMF-së ka rezultuar se së paku deri në vitin 2019 ky automjet ka qenë në pronësi të znj. Pranvera Gruda. DPSHTRR-ja<sup>26</sup> ka bërë me dije se automjeti në fjalë është nxjerrë jashtë përdorimit në datën 12.4.2021, për të cilin është përcjellë dokumentacioni përkatës.
54. Komisioni ka kryer analizën financiare të burimeve të krijimit të pasurisë në analizë për periudhën nga data 1.1.2005 deri më 18.9.2006, kur është blerë pasuria në analizë, për shkak se subjekti nuk ka qenë deklaruese në këto vite. Në këtë analizë janë përllogaritur: (i) të ardhurat nga paga e subjektit dhe bashkëshortit të saj gjatë kësaj periudhe; (ii) shpenzimet jetike; (iii) shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit, siç paraqiten në tabelën në vijim.
55. Në përfundim të sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika lidhur me përfitimin, deklarimin apo burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë automjet.

**Tabela nr. 5** – Analiza e burimeve për krijimin e pasurisë automjet tip “Renault Megane”, në datën 18.9.2006

Të ardhura nga paga e subjektit	1,275,429
Të ardhura nga paga e b/shortit	740,340
Shpenzime jetese	(730,380)
Shpenzime mobilimi	(265,000)
Shpenzime udhëtimi	(30,635)
Ndryshim likuiditeti bankë	(354,914)
Shpenzim për blerje automjeti	(250,000)
<b>Rezultati</b>	<b>384,840</b>

## 3. Depozitë kursimi në shumën 579.078 lekë, depozitë 24-mujore në shumën 500.000 lekë dhe llogari rrjedhëse e pagës në shumën 100.693 lekë, në Credins Bank

<sup>26</sup> Me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 22.6.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 26.5.2023.

56. Credins Bank<sup>27</sup> ka bërë me dije se subjekti i rivlerësimit ka qenë kliente e kësaj banke dhe ka përcjellë historikun e llogarive të saj. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë ka rezultuar se subjekti ka disponuar një llogari rrjedhëse në lekë në këtë bankë, si dhe depozitën në shumën 500.000 lekë, të krijuar prej vitit 2012, e mbartur edhe në vitin 2016 në shumën 587.944 lekë, me burim krijimi nga paga.
57. Për sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të gjendjeve në llogaritë bankare të subjektit, në Credins Bank.

#### 4. Gjendje *cash* në vlerat 350.000 lekë dhe 8.000 euro, me burim nga kursimet

58. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* kursimet *cash* në masën 350.000 lekë dhe 8.000 euro. Komisioni vëren se në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 dhe në DIPP-në e vitit 2004 subjekti nuk ka deklaruar kursime në likuiditete *cash*. Për rrjedhojë, Komisioni kreu analizën financiare me qëllim verifikimin e disponibilitetit për krijimin e shumave në fjalë, duke konsideruar të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit të saj, si dhe shpenzimet, duke filluar nga data 1.1.2005, siç paraqitet në mënyrë të detajuar në tabelën në vijim.

**Tabela nr. 6** – Analiza financiare për krijimin e kursimeve *cash* për periudhën 1.1.2005 – 27.1.2017

Të ardhura nga paga e subjektit	10,313,369
Të ardhura nga paga e b/shortit	6,158,632
Të ardhura nga paga e bija e subjektit	723,923
Të ardhura nga Interesat bankare	294,199
Shpenzime jetese	(7,518,169)
Shpenzim për blerje automjeti 2006	(250,000)
Shpenzime mobilimi	(974,000)
Shpenzime për arsimin e vajzes	(153,300)
Shpenzime për arsimin e djalit	(317,759)
Shpenzime udhëtimi	(1,180,191)
Shpenzime të tjera	(19,000)
Ndryshim likuiditeti <i>cash</i>	(1,432,160)
Ndryshim likuiditeti bankë	(1,390,596)
<b>Rezultati</b>	<b>4,254,947</b>

59. Nga sa më sipër ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e likuiditeteve *cash* në vlerat 350.000 lekë dhe 8.000 euro, të deklaruara në deklaratën *Vetting*.

#### *Pasuri të regjistruara veçmas të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit*

#### 5. Truall me sipërfaqe 345 m<sup>2</sup>, nga e cila 118 m<sup>2</sup> ndërtesë, përfitur me anë të trashëgimisë

60. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* bashkëpronësinë e tij dhe pjesën takuese prej 1/6 në pasurinë truall me sip. 345 m<sup>2</sup>, nga e cila 118 m<sup>2</sup> ndërtesë, me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, rruga “\*\*\*\*”, Shkodër. Kjo pasuri është përfitur me trashëgimi nga z. G.

<sup>27</sup> Me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 30.6.2017 dhe nr. \*\*\* prot, datë 21.6.2021.



61. ASHK Shkodër<sup>28</sup> ka përcjellë: vendimin nr. \*\*\*, datë 7.2.2012, për lëshimin e trashëgimisë; vërtetimin e pronësisë datë 7.11.1979<sup>29</sup>; vërtetimin nga dokumenti hipotekor nr. \*\*\*, datë 10.9.2002, për pasurinë në analizë; vendimin nr. \*\*\*, datë 6.7.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; dokumentin nr. \*\*\* prot., datë 29.10.2012, për afishimin publik të pasurisë; vendimin nr. \*\*\*, datë 17.1.2013, për regjistrimin e pasurisë në emër të trashëgimtarëve të pasurisë nr. \*\*\*, në z. k. \*\*\*; certifikatën e pronësisë datë 1.2.2013, në emër të bashkëpronarëve të tjerë dhe të z. A. G.
62. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në dosjen e ILDKPKI-së certifikatën e pronësisë për pasurinë nr. \*\*\*, të ndodhur në z. k. \*\*\*, në emër të bashkëpronarëve dhe bashkëshortit të saj, lëshuar në datën 1.2.2018. Kjo pasuri është përfutur prej bashkëshortit nëpërmjet dëshmisë së trashëgimisë datë 23.1.1994, me anë të vendimit nr. \*\*\*, datë 3.2.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për lëshimin e dëshmisë të trashëgimisë të ndjerës nënës së bashkëshortit. Po ashtu, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se nëpërmjet vendimit nr. \*\*\* të vitit 1996, nga KKKPronave është bërë njohja e pronësisë së të ndjerit, babai të tij, për sipërfaqen totale prej 8.692 m<sup>2</sup> truall, ku aktualisht është Stadiumi i Shkodrës dhe se prej bashkëpronarëve është ruajtur e drejta e parablerjes.
63. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit depozitoi dokumentacionin: vërtetim pronësie të Hipotekës Shkodër, të vitit 1996; certifikatë për vërtetimin e pronësisë; dëshmi trashëgimie; vendim gjykate dhe vendim të KKP-së Shkodër; shkresë datë 24.5.2023, nga ASHK Shkodër, ku është konfirmuar se kjo pasuri nuk është tjetërsuar dhe është e të njëjtëve trashëgimtarë.
64. Ndërsa, lidhur me statusin juridik aktual të kësaj pasurie, subjekti ka shpjeguar se pasuria është njohur dhe jo kthyer dhe se bashkëpronarët kanë të drejtën e parablerjes, pasi aty ndodhet Stadiumi i Shkodrës. Po ashtu ka sqaruar se në këto sipërfaqe nuk është kryer asnjë investim nga ana e tyre si bashkëshortë dhe as nga bashkëpronarët e tjerë, duke paraqitur edhe disa foto, nga të cilat duket një ndërtesë e pabanuar dhe e painvestuar.
65. Në përfundim të sa më sipër ka rezultuar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me përfitimin, deklarimin apo mbi burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë në fjalë, për sa kohë ajo rrjedh nga trashëgimia ligjore.

#### **6. Llogari rrjedhëse e pagës në Raiffeisen Bank, në shumën 4.703 lekë dhe llogari rrjedhëse e pagës në BKT, me gjendje në shumën 801 lekë**

66. Lidhur me llogaritë e sipërcituara, të deklaruara nga bashkëshorti i subjektit përgjatë procesit të rivlerësimit, ka rezultuar se ato janë përdorur për marrjen e pagës nga bashkëshorti i subjektit.
67. Në këto kushte nuk kanë rezultuar problematika lidhur me burimin e furnizimit të këtyre llogarive, gjendjen e disponuar dhe me deklarimin e tyre nga subjekti i rivlerësimit.

### **REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE**

<sup>28</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.7.2023.

<sup>29</sup> Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se i ndjeri H. G., në bazë të notës-transkriptimit të radhorit të pronësisë nr. \*\*\*, datë 23.12.1978, ka pasur të regjistruar pranë kësaj zyre pasurinë në fjalë, e cila përbëhej nga dy dhoma, një kuzhinë dhe oborr.

68. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet ndër vite të subjektit, pas përlogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlogaritja krahasimore e tyre mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për çdo vit për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
69. Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2003, moment në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, nga ku ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm pozitiv, siç është detajuar në tabelën e mëposhtme.

### Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016

Periudha/ Viti	1993-2002	2003	2004	01/01/2005-27/01/2017
<b>PASURI</b>	<b>3,208,837</b>	<b>0</b>	<b>4,041</b>	<b>3,072,756</b>
Apartament banimi ne Shkoder blere ne dt. 24.11.2000	0			
Apartament banimi ne Tirane	3,208,837			
Automjet Renault Megane blere dt. 18.09.2006				250,000
Ndryshim likuiditeti banke	0	0	4,041	1,390,596
Ndryshim likuiditeti cash		0	0	1,432,160
<b>Të ARDHURA dokumentuar</b>	<b>5,535,620</b>	<b>517,324</b>	<b>905,272</b>	<b>17,490,123</b>
Te ardhura nga paga e subjektit		402,174	640,962	10,313,369
Te ardhura nga paga e b/shortit		82,150	264,310	6,158,632
Te ardhura nga e vjehrrit nga kursimet	80,000			
Te ardhura nga Vendimi I Gjykeses se Rrethit Tirane	188,050			
Te ardhura nga shitja e automjetit	500,000			
Te ardhura nga shitja e pronës		33,000		
Te ardhura nga shitja e pasurisë ne Shkoder ne 1999	1,000,000			
Te ardhura deri ne date 31.12.2002, subjekti	3,240,085			
Te ardhura deri ne date 31.12.2002, bashkeshorti	527,485			
Te ardhura nga interesa bankare subjekti ne Credins Bank				70,845
Te ardhura nga interesa bankare subjekti ne Credins Bank				69,816
Te ardhura nga interesa bankare bashkeshorti Credins Bank				61,426
Te ardhura nga paga dhe shperblime e bija				588,626
Te ardhura nga puna part time prane kompanise *** Tirane janar-mars 2011 e bija				97,956
Te ardhura si anketuese Census, kredituar ne Credins e bija				37,341
Te ardhura nga interesa bankare bashkeshorti RB				32,980
Te ardhura nga interesa bankare SR Intesa Sanpaolo Bank				59,132
<b>SHPENZIME</b>	<b>2,380,382</b>	<b>375,856</b>	<b>429,087</b>	<b>10,162,419</b>
Shpenzime jetese		375,856	375,856	7,518,169
Shpenzime jetese deri ne date 31.12.2002	1,880,382			
Shpenzime mobilimi				974,000
Shpenzime per arsimimin e vajzes				153,300
Shpenzime per arsimimin e djalit				218,336
Shpenzime udhetimi dhe qendrimi jashte vendit			53,231	1,180,191
Shpenzime te tjera (Praktike Profesionale U.Farmacisteve, dep. ne BKT 15.7.2015)				10,000
Sicred Pension SR				8,000
Sicred Pension e bija				1,000
Blerje automjeti	500,000			
Shpenzim per pagimin e campusit te djalit (EP)				99,423
<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>-53,599</b>	<b>141,468</b>	<b>472,144</b>	<b>4,254,948</b>
<b>DIFERENCA E PAMBULUAR</b>	<b>-53,599</b>			

70. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, vlerëson se znj. Pranvera Gruda ka arritur një nivel të besueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, duke justifikuar dhe shpjeguar bindshëm të gjitha pasuritë e analizuara ku rezultoi të ishte e përfshirë. Kësisoj, trupi gjykues çmon se mungesa e këtyre burimeve – me balancë negative minimale të mjeteve monetare – nuk përbën shkak të mjaftueshëm për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe përcaktimit të pikës 1 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

71. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë pranë Komisionit një raport për subjektin e rivlerësimit Pranvera Gruda, me nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2017, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit për vazhdimin e detyrës.

72. Me shkresat e datave 7 dhe 15 gusht 2023, AKSIK-ja i ka bërë me dije Komisionit se nuk ka pasur informacione të tjera të mbërritura nga institucionet verifikuese, kësisoj konfirmohet konstatimi për përshtatshmëri të subjektit, sikurse konkludohej në raportin e sipërcituar, i cili më vonë është deklasifikuar në datën 30.8.2023, me vendimin nr. \*\*\*, të KDZH-së.

73. Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka rezultuar që subjekti të ketë qenë i përfshirë në veprimtari të kundërligjshme apo të ketë pasur ndonjë kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kësisoj, në përfundim të hetimit për kriterin e kontrollit të figurës, bazuar në informacionet dhe dokumentet e administruara, duket se subjekti i rivlerësimit Pranvera Gruda arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nga verifikimet e kryera: (i) nuk rezultoi se ajo ka pasur apo të ketë aktualisht kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (ii) ka dorëzuar në kohë deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk ka bërë deklaratime të pasakta, të paplota dhe nuk ka fshehur të dhëna apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

## **C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

74. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Pranvera Gruda, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës.

75. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në: (a) raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer dhe të përcjellë në Komision; (b) informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncimet dhe organet ligjzbatuese, burime të cilat, kur ka qenë nevoja, i janë nënshtruar verifikimit të vërtetësisë së tyre nga Komisioni; (c) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

76. Raporti i përcjellë nga KLP-ja është kontrolluar në drejtim të saktësisë dhe standardizimit të tij, raport i cili ka të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të

vlerësimit, si: (i) aftësitë profesionale; (ii) aftësitë organizative; (iii) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (iv) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

77. Nga verifikimi në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme ka rezultuar se gjatë 3 viteve të fundit të ushtrimit të detyrës ajo ka mbajtur pozicionin ndihmëse ligjore pranë Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, e pozicionuar pranë Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, më pas në Drejtorinë Gjyqësore, dhe e ka ushtruar detyrën kryesisht në fushën e së drejtës penale dhe civile-administrative.

Nga të dhënat statistikore për periudhën e rivlerësimit, znj. Pranvera Gruda, në cilësinë e ndihmëses ligjore në Prokurorinë e Përgjithshme, ka trajtuar gjithsej 53 çështje<sup>30</sup>.

79. Për periudhën 2006 – 2021 ka rezultuar ankesa nr. \*\*\*, viti 2021, e avokatit F. Gj., e cila nuk është pranuar nga Prokuroria e Përgjithshme, pasi ka qenë objekt shqyrtimi nga gjykata.

80. Në përfundim të analizimit të materialeve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues nuk ka konstatuar shkelje procedurale në vlerësimin e subjektit në lidhje me këtë ankesë.

### **C/1. Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni**

81. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet publike, të administruara për këtë qëllim. Për sa i përket tri dokumenteve të vëna në dispozicion nga subjekti, por edhe atyre të administruara mbi bazë shorti, Komisioni përgjithësisht nuk ka konstatuar problematika.

### **DENONCIME**

82. Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë paraqitur 2 denoncime nga publiku, të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim të analizimit të materialeve përkatëse lidhur me disa denoncime, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016 janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore për vlerësime më të thella lidhur me aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit, siç janë trajtuar në vijim:

#### **1. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 13.3.2023, i shtetasit K. H.**

83. Denoncuesi ka ngritur pretendime lidhur me një proces gjyqësor, ku subjekti i rivlerësimit ka përfaqësuar organin e Prokurorisë, duke parashtruar se subjekti në bashkëpunim me të tjerë është futur në rrjetin social, duke krijuar një koment denigrues për figurën e tij.

84. Komisioni ka administruar<sup>31</sup> dokumentacionin që i përket çështjes objekt denoncimi, të finalizuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.1.2022, të Gjykatës Administrative Tiranë. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni është konstatuar se denoncuesi, në cilësinë e paditësit, ka kërkuar dëmshpërblim jopasuror nga Prokuroria e Rrethit Tiranë, në cilësinë e palës së paditur në këtë proces. Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së denoncuesit. Po

<sup>30</sup> Kjo dokumentohet me procesverbalin “Për pasqyrimin e veprimeve të përzgjedhjes së 5 dosjeve për subjektin e rivlerësimit znj. Pranvera Gruda”, datë 22.1.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe vërtetimin datë 21.1.2021 të Prokurorisë së Përgjithshme, të administruar nga KLP-ja.

<sup>31</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.6.2023.

ashtu ka rezultuar se organi i Prokurorisë nuk është përfaqësuar në gjykim nga subjekti i rivlerësimit Pranvera Gruda, por nga dy përfaqësuese të tjera.

85. Për sa më sipër, nuk janë evidentuar *indicie* lidhur me veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit për të thelluar hetimin.

## **2. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2021, i shtetasit A. Ç.**

86. Ky shtetas pretendon se nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk janë kryer hetime dhe, në kundërshtim me ligjin, me anë të vendimit nr. \*\*\* prot., datë 3.9.2020, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal të liruarit me kusht.

87. Nga shqyrtimi i vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. \*\*\*, datë 9.7.2020, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka konstatuar se kallëzimi kishte të njëjtën përmbajtje me një tjetër kallëzim, për të cilin, me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.1.2020, ishte vendosur mosfillimi i procedimit.

88. Në vijim, subjekti, me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.9.2020, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke arsyetuar ndër të tjera se fakti i ndodhur nuk përmban elementet e ndonjë vepre penale. Ky vendim është ankimuar nga denoncuesi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjykata, me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.3.2021, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së ankuesit/denoncuesit A. Ç. Vendimi në fjalë ka rezultuar i lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.5.2021.

89. Po ashtu denoncuesi ka depozituar ankesën/at e tij në ILD, ku pas shqyrtimit të saj është vendosur me vendimin nr. \*\*\* prot., datë 26.4.2021, se nuk ka fakte të mjaftueshme për të filluar hetimin ndaj subjektit të rivlerësimit, duke e arkivuar atë. Me këtë vendim është njoftuar edhe denoncuesi me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.9.2023.

90. Për sa më sipër, sikurse është konfirmuar edhe nga gjykatat në të dyja shkallët, si dhe është konstatuar edhe nga ILD-ja, nuk kanë rezultuar shkelje procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit lidhur me procedimin objekt denoncimi.

## **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Pranvera Gruda:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr.

84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Pranvera Gruda.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 24.11.2023.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Kryesuese**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Relator**

**Brunilda BEKTESHI**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Jonida Vrana*